



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.08.2022

**MBLEDHJA Nr. 35,**  
**Datë 17.08.2022, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 17.08.2022, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 35 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 10.08.2022
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin korrik 2022
3. Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 70, datë 11.04.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k., me vendimin nr. 99, datë 16.04.2021” dhe rishikimin e vendimit nr. 99, datë 16.04.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW”
4. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike” dhe mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 168, datë 28.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”
5. Mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike
6. Mbi heqjen e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 137, datë 06.09.2017
7. Mbi miratimin e ndryshimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**